ANEMIA ME QELIZA DRAPËR

1. Çfarë është anemia me qeliza drapër?

Anemia me qeliza drapër (ose drepanocitoza) është një sëmundje gjenetike e gjakut.

Ajo prek qelizat e kuqe të gjakut, të cilat transportojnë oksigjenin nga mushkëritë në gjithë trupin.

Sëmundja shkaktohet nga një problem në një proteinë të quajtur **hemoglobinë**.

Tek pacientët me këtë sëmundje, hemoglobina është e ndryshme nga normalja dhe quhet **hemoglobinë S**.

Format e sëmundjes

- **Sëmundja (homozigoza βS/βS)**

Personat kanë dy kopje të gjenit të ndryshuar.

Ata kanë qeliza të kuqe që dëmtohen lehtë dhe shpesh mund të marrin "formë drapëri".

- **Bartës të shëndetshëm (heterozigotë βS/β)**

Kanë vetëm një kopje të gjenit të ndryshuar.

Zakonisht **nuk kanë simptoma** dhe jetojnë një jetë normale.

Diagnoza

Për të kuptuar nëse një person ka sëmundjen apo është bartës, duhen dy analiza:

- **emocromo** (numërimi i qelizave të gjakut)
- **elektroforeza e hemoglobinës** (tregon nëse ka forma anormale të hemoglobinës)

---

2. Si janë qelizat e kuqe në njerëzit e shëndetshëm dhe në pacientët?

- Tek një person i shëndetshëm, qelizat e kuqe janë **të rrumbullakëta, të buta dhe elastike**.

  Ato rrjedhin lehtë edhe në enët më të holla të gjakut.

- Tek personat me anemi drapër, në disa situata qelizat e kuqe:
  - ndryshojnë formë dhe bëhen si drapër, të zgjatura dhe të ngurta
  - ngjiten me njëra-tjetrën
  - bllokojnë enët e vogla të gjakut
  - nuk arrijnë të çojnë oksigjenin në inde

Situatat që favorizojnë deformimin drapër jane:

mungesë oksigjeni, i ftohti, chidratimi, infeksionet, sforcë fizike e madhe

Pasojat

- Indet nuk marrin oksigjen → shkaktojnë **dhimbje të forta** dhe dëmtim të mundshëm të organeve.
- Qelizat e kuqe dëmtohen shpejt dhe jetojnë vetëm **10–20 ditë** (norma është rreth 4 muaj).
- Kjo shkakton **anemi kronike.**

---

3. Çfarë simptomash mund të ketë një person me anemi drapër?

Simptoma nga anemia kronike

- lodhje
- vështirësi në përqendrim
- rritje më e ngadaltë tek fëmijët
- zverdhje e lëkurës dhe syve (ittero)

Krizat e dhimbshme: VOC

Simptomat më te shpeshta dhe më te rëndësishme janë:

krizat me qeliza drapër ose **krizat vaso-okluzive (VOC)**

Ato janë:

- shumë të dhimbshme
- të përsëritura
- të paparashikueshme
- të mundshme në çdo moshë
- mund të zgjasin deri **në 10 ditë**

VOC **është arsyeja kryesore e urgjencave dhe e shtrimeve në spital.**

Komplikime akute të tjera

Mund të jenë shumë serioze:

- **sindroma akute te kraharorit**
- goditje cerebrale **(iktus**) ose probleme të tjera të trurit
- **anemi e rëndë e akute** për shkak të “grumbullimit” të qelizave të kuqe në shpretkë ose në mëlçi
- **infeksione të rënda**
- probleme në kocka dhe artikulacione
- **priapizëm** (ereksion i gjatë dhe i dhimbshëm, jo i lidhur me dëshirë)

Komplikime kronike

Me kalimin e viteve sëmundja mund të dëmtojë organe të ndryshme si:

- zemrën
- mushkëritë
- veshkat

---

4.  Kur duhet të shqetësohemi?

Një person me anemi drapër duhet **të kontaktojë menjëherë** mjekun, pediatrin ose qendrën e referimit, ose të shkojë në urgjencë nëse shfaqen:

- **zbehje e fortë ose zverdhje**, me ose pa temperaturë të lartë
- **dhimbje të forta në bark**, me të vjella dhe/ose temperaturë